REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KRYETARI

Nr. 3545 prot. Ballsh më, 22.10.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 65 Datë 22 / 10 / 2026

PËR

MIRATIMIN E KOMPENSIMIT TË SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT PËR NXËNËSIT PËR VITIN SHKOLLOR 2026-2027

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe konstatimet e kryera mbi vështirësitë e lëvizjes në akset rrugore të mëposhtme dhe për të garantuar mundësimin që fëmijët/nxënësit e këtyre shkollave të zhvillojnë një proces normal mësimor",

PROPOZOJ

1. Kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën 100 (njëqind) lekë / nxënës për çdo ditë për vitin shkollor 2026-2027, në linjat e mëposhtme:
   - *Selitë - Shkolla 9 – Vjeçare Fratar*
   - *Çërrilë – Shkolla 9 – Vjeçare Gjerbës*
   - *Rripan - Shkolla 9 – Vjeçare Ngraçan*
   - *Ngraçie - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë*
   - *Belishovë - Shkolla 9 – Vjeçare Visokë*
   - *Gadurovë - Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh*
   - *Ramaj – Shkolla 9 – Vjeçare Ninësh*
   - *Muçaj, Bozhaj – Shkolla 9 -Vjeçare Aranitas*

- Në kompensimin e shpenzimeve të transportit në masën e sipërcituar përfshihen dhe nxënësit me AK të cilët nuk e zhvillojnë procesin mësimor pranë vendbanimit të tyre (edhe në linjat të cilat nuk janë parashikuar më sipër).

2. Shpenzimet do të mbulohen nga nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër, artikulli 602.
3. Efektet finaciare fillojnë nga data 14.09.2026.

Konceptoi: E. Hoxhaj
P / Sektori Juridik: N.Sakaj
Drejtor Ekonomik: A.Rama

KRYETAR

Qerim Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALLAKASTËR